



UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 24, datë 20.11.2017

“Për miratimin e Planit të Veprimit me qëllim përmbushjen brenda afatit të përcaktuar të të gjitha rekomandimeve të Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.62, datë 21.09.2017”

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” në nenin 38, si dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës në nenin 20, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, pasi mori në shqyrtim projekt propozimin e Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet e Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.62, të paraqitur nga grupi i punës i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 20, datë 05.10.2017, në mbledhjen e datës 20.11.2017;

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Veprimit me qëllim përmbushjen brenda afatit të përcaktuar të të gjitha rekomandimeve të Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.62, datë 21.09.2017, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI